



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2022:128221
Datë: 16.12.2024
Numri i dokumentit: 06599904

K.DH.SH.II.nr.607/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbaremore të kreditorit “Liburnia Impex” ShPK me seli në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat Valdet Hoxha, nga Prizreni, kundër debitorit “Sollobaja” ShPK me seli në Podujevë, të cilën me autorizim e përfaqëson Virtyt Ibrahimaga, avokat nga Prishtina, me baze juridike përmbaremore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.675/23 të datës 29.12.2023, me datën 16.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “Liburnia Impex” ShPK me seli në Prizren, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.675/23 i datës 29.12.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “Sollobaja” ShPK me seli në Podujevë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbaremit P.nr.228/22 dt.30.05.2022 i Përmbaremit Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren dhe MBETET NË FUQI Urdhri për përmbaremi P.nr.228/22 dt.30.05.2022 i Përmbaremit Privat Rushit Hoxha.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.675/23 të datës 29.12.2023, e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Sollobaja” ShPK me seli në Podujevë dhe shfuqizohet urdhri përmbaremit P.nr.298/2022 i datës 30.05.2022 i përmbaremit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale te dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që gjykata e shkallës së dytë ankesën e kreditorit ta aprovojë si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që të refuzojë prapësimin e debitorit, duke e lënë në fuqi urdhrin përmbaremit ta shfuqizoj dhe ta obligoj kreditorin te paguaj shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne ankesën e kreditorit nuk ka ushtruar debitori.

Dhomat e Shkalles se Dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtuan shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Liburnia Impex” ShPK me seli në Prizren më 30.05.2022 ka parashtruar propozim për përmbartim në zyrën e përmbartuesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, me të cilin ka kërkuar që të detyrohen debitori “Sollobaja” ShPK me seli në Podujevë që ta paguaj shumën prej 7,999.92€ me kamatë ligjore që nga data e dorëzimit të faturave si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim e kishte bazuar në faturën nr.2703049 të datës 29.04.2021 të tij për Debitorin, të cilën në kopje të vërtetuar te noteri ia ka bashkëngjitur Propozimit. Përmbartuesi më 30.05.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.298/2022 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të prapësimit dhe shkresave ne lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.675/23 të datës 29.12.2023, me të cilin e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Sollobaja” ShPK me seli në Podujevë dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.298/2022 të datës 30.05.2022 të përmbartuesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren. Sipas arsyeve të dhëna në aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë bazuar në Nenin 38 të LPP-së ka ardhur në përfundim se propozimi për përmbartim, mes tjerash, duhet ta përmbajë numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, kur ky është shoqëri tregtare, ndërsa numrin personal të debitorit kur ky është person fizik, kurse në rast se në propozimi për përmbartim nuk e përmban këtë të dhënë, atëherë organi përmbartues është i obliguar që të veprojnë sipas nenit 102 të LPK-së, sipas të cilit propozimi për përmbartim, si parashtesë, duhet të kthehet për korigjim. Në rastin konkret, te të dhënat e Debitorit mungon numri i regjistrimit të biznesit për Debitorin, ndërsa siç u sqarua edhe më lartë, Përmbartuesi ka dështuar që ta ftoj Kreditorin që ta rregullojë Propozimin në kuptim të të dhënave të Debitorit. Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 43 par.4 të LPP-së gjykata e ka aprovuar prapësimin dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar.

Sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë, gjykata e shkallës së parë me rastin e trajtimit të çështjes shfuqizimin e urdhrin për përmbarim e ka marrë duke u bazuar në mangësitë e propozimit për përmbarim që i referohen numrit të biznesit të debitorit, duke u bazuar në dispozitat e Nenit 38 par 2 dhe 43.4 të LPP-së. Sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë qëndron fakti se propozimi për përmbarim është iniciuar pa u përfshirë të dhënat e detajuara të debitorit, përfshirë këtu adresën e saktë dhe/apo numrin e biznesit. Në këtë kuptim, qëndron fakti se propozimi për përmbarim duhet të përmbajë të dhënat nga Neni 38 par.1 i LPP-së përfshirë këtu *“kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*. Në këtë kuptim, paragrafi 1 i Nenit 38 paraqet rregullin primar si kusht për të ekzistuar rregullsisht e propozimit për përmbarim. Duhet theksuar se tek ky kusht primar të dhënat e detajuara, përfshirë këtu numrin e biznesit, nuk parashihen t’i përmbajë propozimi për përmbarim. Më tej, në interpretim të dispozitës së Nenit 38 par.2 është i njohur detyrimi i përmbaruesit privat si organ i shkallës së parë që të veprojë në drejtim të evitimit të mangësive, përfshirë këtu edhe numrin e biznesit të subjektit juridik.

Përkitazi me lëshimet e përmbaruesit privat, megjithatë propozimi për përmbarim është lejuar dhe ndaj tij ka parashtruar prapësim debitori. Është me rëndësi se debitori nuk e ka kontestuar ndonjë mangësi në subjektivitetin juridik të debitorit dhe as legjitimitetin në këtë procedurë si palë pasive. Rrjedhimisht, është fakt i pa kontestuar se debitori është legjitimuar si palë pasive në procedurë, pavarësisht mangësive në identifikimin si subjekt juridik. Së këndejmi, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se çështja e mangësive siç është numri i biznesit i atribuohet lëshimeve eventuale të kreditorit. Mirëpo fakti se në rastin konkret kreditori ka arritur ta identifikojë debitorin si palë legjitime në këtë procedurë, shqyrtimi i defekteve të natyrës jopërmbarësore e bën të parëndësishëm për gjykatën trajtimin e këtyre aspekteve të propozimit për përmbarim.

Sipas Dhomave të Shkallës së Dytë gjykata e shkallës së parë ka pasur tagër të shqyrtojë rregullsinë e propozimit për përmbarim përfshirë këtu prapësimin proceduralë dhe materiale të palës debitore, pra aspektet teknike të propozimit nuk janë kontestuar nga debitori. Prapësimi atakon rregullsinë e përmbarimit në drejtim të parregullsisë së faturës, duke e kontestuar faktin se faturën nuk e ka nënshkruar drejtori i debitorit.

Dhomat e Shkallës së Dytë bazuar në shqyrtimin shkresor, analizimit të provave dhe pretendimeve të palëve vlerësoi gjendje tjetër faktike në raport me gjykatën e shkallës së parë, andaj vendosi që aktvendimi i atakuar të ndryshohet. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 i LPP-së.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës nr.2703049 të datës 29.04.2021 së noterizuar, e lëshuar nga kreditori e cila është e nënshkruar nga debitori me datë 29.04.2021, çka rezulton se është pranuar në mënyrë të rregullt nga i njëjti, shtu këtu edhe faktin se në shkresa të lëndës gjendet dëshmi se palët kanë nënshkruar kontratë për furnizim me mall me datë 13.12.2019. Rrjedhimisht, gjykata e shkallës së dytë vie në përfundim se me faktin se debitori e ka pranuar me anë të nënshkrimit faturën, nënshkrim ky i cili përkon me atë të kontratës mes palëve, rezulton se fatura është pranuar me rregull nga debitori. I njëjti përmes prapësimit të ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar vetëm në mënyrë deklarative e kundërshton nënshkrimin pa dhënë as të vetmin argument për parregullsinë e faturës. Prandaj, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se në rastin konkret prapësimi i debitorit edhe pretendimet se mungon nënshkrimi i debitorit nuk qëndron. Kjo gjykatë thekson se nënshkrimi dhe/apo vula paraqet element dëshmie për pranim të faturës. Në momentin kur debitori ka nënshkruar faturën e rregullt pa e kundërshtuar atë paraprakisht, nuk mund të merret si prapësim i rregullt vetëm përmes deklaramit në prapësim

Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se fatura objekt përmbartimi e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 e LPP-së dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, sepse i përmban elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* si dhe është në pajtim me nenin 37 të LPP-së i cili thotë se *“kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata e shkallës së dytë në bazë të shqyrtimit të shkresave të lëndës nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me pranimin e prapësimit, respektivisht ka vërtetuar gjendje tjetër faktike duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për ndryshimin e aktvendimit të atakuar dhe vendosjen e çështjes në shkallë të dytë.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore qe aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbartim.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.607/24, me datë 16.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova